



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 909/1 Prot

Tiranë, më 2 / 9 / 2016

Lënda: Jepet mendim mbi projektvendimin "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për menaxhimin elektronik të gjobave (E-gjoba)".

Drejtuar: Z. Saimir TAHIRI
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

I nderuar z.Tahiri,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 2583/2 Prot., datë 23.08.2016, projektvendimi "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për menaxhimin elektronik të gjobave (E-gjoba)", vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Ndërkohë, sugjerojmë që në bazën ligjore të projektvendimit, të referohet edhe neni 127 "Siguria dhe konfidencialiteti" i ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

Gjithashtu, pas pikës 8 të shtohet një pikë, konform përcaktimeve të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me përmbajtje si vijon:

"Informimi i çdo shtetasi për përpunimin e të dhënave personale në sistemin E-gjoba vihet në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Policisë së Shtetit. www.asp.gov.al në një rubrikë të veçantë "Politika e privatësisë" sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në pikën 12 të shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:

"Aksesi i subjekteve të interesuara në këtë sistem është i kufizuar sipas legjislacionit që rregullon veprimtarinë e tyre dhe qëllimin e përpunimit".

Përmbajtja e pikës 14 të riformulohet si vijon:

“Organizimi, funksionimi i brendshëm i bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba), aksesit dhe detyrimet e subjekteve të interesuara sipas pikës 12 për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, përcaktohen në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore, të miratuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI